



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Përdorimi i Masave të Përkohshme në Procedurat  
Civile në Kosovë**

**SMSJ Edicioni 11  
Dhjetor 2010**

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport shqyrton gjykimin e propozimeve urgjente për masa të përkohshme nga gjykatat në Kosovë, në kontekst të procedurave civile. Raporti përfundon se, përkundër kushteve të qarta të parapara si me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe kornizën ligjore në Kosovë, gjykatat shpesh dështojnë t'i marrin parasysh propozimet për masa të përkohshme në mënyrë të shpejtë, apo me përkushtim të duhur, dhe në shumë raste krejtësisht dështojnë t'i trajtojnë këto propozime. Raporti nënvizon se caktimi i masave të përkohshme mund të jetë i domosdoshëm për të siguruar efikasitetin e aktgjykimit përfundimtar të vendosur mbi merita të padisë. Raporti paralajmëron se kur gjykatat dështojnë t'i trajtojnë propozimet e tilla në mënyrë të zellshme dhe pa vonesa, përbarimi i aktgjykimit përfundimtar mund të vendoset në rrezik të konsiderueshëm.

## **HYRJE**

Caktimi i masave të përkohshme është një mjet i fuqishëm dhe i rëndësishëm në dispozicion të palëve ndërgjyqësore në rastet civile. Qëllimi i masave të përkohshme është që të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në rastet pranë gjykatave, duke parandaluar që të ndodhin humbje apo dëme të pariparueshme, para se gjykata të merr vendim përfundimtar mbi meritat e padisë. Masa të tilla më së shpeshti propozohen në raste ku përfshihen konteste pronësore apo padi për borxhe; megjithatë, ato shpesh propozohen edhe në raste gjyqësore familjare. Masat e përkohshme marrin formën e një lloji urdhri të gjykatës që ndalon palën që të ketë në dispozicion, apo në ndonjë tjetër mënyrë të trajtojë asetet e veta derisa është në pritje vendimi mbi merita të rastit. Ato po ashtu mund të marrin formën e urdhrit që disa asete të ngrihen, ose si alternativë të konfiskohen në pritje të aktgjykimit, apo që një shumë të hollash t'i paguhet gjykatës mbi baza të përkohshme.

Korniza ligjore në Kosovë parasheh caktimin e masave të tilla sipas propozimit të palës në rast. Megjithatë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka vërejtur se gjykatat në Kosovë shpesh dështojnë t'i trajtojnë me shpejtësi apo zell të veçantë propozimet për masa të përkohshme, dhe madje në shumë rastet gjykatat dështojnë fare t'i trajtojnë ato propozime. OSBE është e brengosur se dështimet e tilla kornizën ligjore në Kosovë dhe po ashtu mund të shkelin standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim, ky raport përshkruan kornizën ligjore relevante për shqyrtimin propozimeve për masa të përkohshme, si ndërkombëtarisht ashtu edhe në vend. Raporti analizon një numër shembujsh të rasteve të monitoruara nga OSBE gjatë pjesës së dytë të vitit 2010. Ky raport përfundon me një numër rekomandimesh për gjykatat, Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës që janë projektuar për adresimin e problemeve të identifikuar gjatë analizimit të shembujve të rasteve.

## KORNIZA LIGJORE

### A) Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parasheh se, në përcaktimin e “të drejtave dhe obligimeve” të tij/saj, [...] çdo kush ka të drejtë për dëgjim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”<sup>1</sup>

Praktika gjyqësore e kohëve të fundit, e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka përcaktuar se masat e përkohshme normalisht do të bien në rubrikën e të “drejtave civile” për qëllime të Nenit 6(1).<sup>2</sup> Gjykata ka gjetur se;

“në rrethanat ku shumë Shtete Kontraktuese ballafaqohen me ngecje të konsiderueshme në sistemet e tyre të mbingarkuara gjyqësore, që çojnë në procedura të tej-zgjatura, një vendim i gjyqarit për urdhër ndalese shpesh do të jetë baraspeshë për një vendim mbi merita të rastit, për një periudhë të konsiderueshme kohore, madje në raste të veçanta edhe e përhershme. Vazhdon se, shpesh procedurat e përkohshme dhe ato kryesore vendosin të njëjtat ‘të drejta apo obligime civile’ dhe kanë të njëjtat efekte rezultuese të qëndrueshme apo të përhershme.”<sup>3</sup>

GjEDNJ po ashtu ka gjetur se “[b]azuar në materialin që Gjykata ka në dispozicion, në kuptim të legjislacionit të një numri relevant të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, duket se ka një konsensus gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e mbrojtjeve për masa të përkohshme nga Neni 6.”<sup>4</sup>

Kur propozimi për masa të përkohshme del nga konteksti i lëndës nga ligji familjar, ajo mund gjithashtu të përfshijë Nenin 8 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për respektim të “jetës private dhe familjare”.<sup>5</sup> GjEDNJ ka vërejtur se “për shkak të vet natyrës dhe qëllimit të saj, propozimet për masa të përkohshme të ndalesës, normalisht duhet të trajtohen me një shkallë të caktuar prioriteti, përpos nëse ka arsye të veçanta për të mos e bërë këtë.”<sup>6</sup> “Gjykata ka konsideruar se, nën rrethana, detyra e autoriteteve sipas Nenit 8 për të siguruar respektimin e të drejtës për jetë private dhe familjare të së dyve – prindit dhe fëmijës – kërkonte vlerësimin e propozimit për masa

<sup>1</sup> Shih Nenin 6(1), KEDNJ.

<sup>2</sup> Shih *Micallef kundër Maltës*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 15 tetorit 2009, paragrafët 31, 74-75, dhe 78-86.

<sup>3</sup> Ibid, paragrafi 79.

<sup>4</sup> Ibid, paragrafi 31. Shih po ashtu paragrafin 85, ku GjEDNJ ka gjetur se “[k]urdo që masa e përkohshme mund të konsiderohet që në mënyrë efektive përcakton të drejtën apo obligimin civil i cili është në shqyrtim, Neni 6 do të zbatohet, pa marr parasysh kohëzgjatjen që do të jetë në fuqi.”

<sup>5</sup> Shih Nenin 8(1), KEDNJ. GjEDNJ ka gjetur se “[p]ërderisa objekti thelbësor i Nenit 8 është që të mbrohet individi kundër veprimit arbitrar nga ana e autoriteteve publike, veç kësaj mund të ketë obligime të pandara efektive për “respektimin” e jetës private dhe familjare dhe këto obligime mund të përfshijnë adoptimin e masave në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet tyre.” Shih po ashtu *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 12 qershorit 2008, paragrafi 64.

<sup>6</sup> Shih *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 12 qershorit 2008, paragrafi 68.

të përkohshme me zell të veçantë dhe pa vonesa.”<sup>7</sup> GjEDNJ përfundoi se efektet e grumbulluara të dështimit të gjykatës

“për të adoptuar pa vonesa masa të përkohshme të ndalesës, në një situatë që ndikoi negativisht te paditësit [...] rezultoi në dështim për t’i ndihmuar paditësit, përkundër obligimit pozitiv të Shtetit sipas Nenit 8 të Konventës për të siguruar respektimin e jetës së tyre private dhe familjare.”<sup>8</sup>

Kur propozimi për masa të përkohshme del nga konteksti kontestit pronësor, mund të përfshijë Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Ky Nen parasheh se

“[s]jecili person fizik apo juridik ka të drejtën e shfrytëzimit të papenguar të asaj me çfarë posedon. Askush nuk do të privohet nga posedimet e veta përpos nëse është në interes publik dhe objekt i kushteve të parapara me ligj dhe me parime të përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.”<sup>9</sup>

## **B) Korniza Ligjore në Kosovë**

Ligji mbi procedurën kontestimore (LPK) parasheh caktimin e masave të përkohshme në kontekst të tri llojeve të ndryshme të procedurave: ato që përfshijnë padi për të holla, ato që përfshijnë padi për asete të specifikuar dhe ato që dalin nga të drejtat dhe interesat që nuk përfshijnë të holla.<sup>10</sup> Masa të përkohshme mund të caktohen kur paditësi paraqet argument të besueshëm se, po që se nuk caktohen, i padituri do të ndërmerr hapa që ta bëjë të vështirë apo të pamundur përmbarimin kundër aseteve të tij apo saj.<sup>11</sup> Posa të paraqitet një argument i tillë, gjykata mund të “ti [caktoj] përnjëherë masa.”<sup>12</sup>

Në procedurë që përfshin padi për të holla, gjykata mund ta ndalojë të paditurin<sup>13</sup> për të tjetërsuar, fshehur, ngarkuar apo disponuar me asetet e tij apo saj, deri në vlerën që do të mjaftonte sigurimin e padisë, në pritje të vendimit përfundimtar mbi merito.<sup>14</sup> Si alternativë, gjykata mund të kërkojë nga i padituri ose t’i deponojë në gjykatë ose të ja paguajë paditësit drejtpërdrejtë shumën e mjaftueshme që do të siguronte padinë.<sup>15</sup> Kur i padituri është kreditor i palës së tretë, gjykata mund ta urdhërojë atë palë të tretë që të bëjë debitimin e pagesave në gjykatë ose të ja bëjë pagesën drejtpërdrejtë paditësit.<sup>16</sup> Kur i padituri posedon me pronë të paluajtshme, gjykata mund të urdhërojë para-regjistrim në formë të pengut me kamatë ndaj pronës së paluajtshme në pritje të vendimit përfundimtar lidhur me padinë.<sup>17</sup>

<sup>7</sup> Ibid, paragrafi 73.

<sup>8</sup> Ibid, paragrafi 84.

<sup>9</sup> Neni 1, Protokoll i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Fundamentale (Protokollit 1), ETS 009, e hapur për nënshkrim me 20 mars 1952, dhe e ndryshuar me dispozitat nga Protokollit 11, ETS 155, hyri në fuqi me 1 nëntor 1998.

<sup>10</sup> Nenet 299-301, Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore i publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës, Viti III/Nr.38, 20 shtator 2008, (LPK).

<sup>11</sup> Neni 297, LPK.

<sup>12</sup> Neni 303, LPK.

<sup>13</sup> Termet ‘paditësi’ dhe ‘i padituri’ respektivisht, këtu i referohen palës që paraqet propozim për masa të përkohshme dhe palës që përgjigjen lidhur me atë propozim.

<sup>14</sup> Neni 299(1)(a), LPK.

<sup>15</sup> Neni 299(1)(b), LPK.

<sup>16</sup> Neni 299(1)(c), LPK.

<sup>17</sup> Neni 299(1)(d), LPK.

Në procedurat ku përfshihet padia për aset të specifikuar, gjykata mund ta ndalojë të paditurin që të tjetërsojë, fsheh, ngarkoj apo disponojë me aset, në pritje të vendimit përfundimtar mbi merita të rastit.<sup>18</sup> Si alternativë, gjykata mund ta urdhërojë të paditurin që mbi baza të përkohshme ta dorëzoj asetin për ruajtje në gjykatë apo tek paditësi.<sup>19</sup> Gjykata mund ta ndalojë të paditurin nga dëmtimi i asetit dhe mund ta urdhërojë atë të ndërmerr hapa për të ruajtur vlerën e asetit.<sup>20</sup> Në procedurë që përfshin padi e cila del nga e drejta apo interesi që nuk përfshin të holla, gjykata mund ta ndalojë të paditurin nga kryerja e veprimeve të caktuara që do të mund ta dëmtonin pozitën e paditësit.<sup>21</sup> Si alternativë, gjykata mund ta urdhërojë të paditurin që ta deponojë një shumë të caktuar tek pala e tretë e besueshme, në pritje të vendimit përfundimtar mbi padinë.

Gjykata mund të caktojë masa të përkohshme para se të fillojë procedura, si dhe në çfarëdo kohe gjatë procedurës, “derisa ekzekutimi të përfundojë plotësisht”.<sup>22</sup> Propozimi për masa të përkohshme do të bëhet me shkrim;<sup>23</sup> do të tregojë faktet mbi të cilat mbështetet propozimi dhe do të specifikojë se çfarë masa të përkohshme propozohen.<sup>24</sup> Propozimi do t’i dërgohet të paditurit i cili do të ketë shtatë ditë për t’u përgjigjur në të para se të caktohet ndonjë masë e përkohshme.<sup>25</sup> Megjithatë, në rastet kur paditësi mund të demonstrojë urgjencën, “mas[a] e përkohshme [e] sigurimit” mund të caktohet pa i dërguar propozimin të paditurit;<sup>26</sup> në raste të tilla, një kopje e vendimit me të cilin caktohet masa e përkohshme e sigurimit do t’i dërgohet menjëherë të paditurit, i cili do të ketë tri ditë për t’u përgjigjur.<sup>27</sup>

## **PËRDORIMI I MASAVE TË PËRKOSSHME NË RASTET CIVILE NË KOSOVË**

Vështrimet e OSBE-së zbulojnë se në rastet civile, kur masat e përkohshme propozohen nga njëra prej palëve, gjykatat shpesh dështojnë në tërësi t’i shqyrtojnë këto propozime. Megjithatë, në rastet kur propozimet e tilla trajtohen nga gjykatat, ato shumë shpesh nuk procedohen me zell apo me kohë, siç kërkohet me kornizën ligjore.

Në mars të vitit 2009, paditësja ngriti një padi për kujdestari të fëmijës së lindur nga “bashkësia faktike” e saj me të paditurin. Faktet sugjerorin se, kur palët u ndanë, fëmija, në atë kohë më i ri se një vjeç dhe akoma duke u

<sup>18</sup> Neni 300(1)(a), LPK.

<sup>19</sup> Neni 300(1)(b), LPK.

<sup>20</sup> Neni 300(1)(c), LPK. Gjykata mund po ashtu ta autorizojë paditësin të kryej veprime të caktuara në lidhje me asetin: Neni 300(1)(d).

<sup>21</sup> Neni 301(1)(a), LPK. Siç është rasti me padi për aset të specifikuar, gjykata po ashtu mund autorizojë paditësin të kryej veprime të caktuara: Neni 301(1)(b).

<sup>22</sup> Neni 304(1), LPK. Kur masat e përkohshme caktohen para fillimit të procedurës, paditësi do të urdhërohet të fillojë procedurën brenda afati të caktuar prej “jo më [të] shkurtër se tridhjetë (30) ditor”: Neni 308(1).

<sup>23</sup> Neni 304(2), LPK. Megjithatë, kur propozimi ka të bëjë me “procesin gjyqësor që është në zhvillim e sipër”, mund të bëhet gojarisht gjatë seancës gjyqësore.

<sup>24</sup> Neni 304(3), LPK.

<sup>25</sup> Neni 305, LPK.

<sup>26</sup> Neni 306(1), LPK.

<sup>27</sup> Neni 306(2), LPK. Posa të kalojnë tre ditë, do të caktohet seanca në përfundim të së cilës gjykata ose do ta “anulojë” vendimin për caktim të masës së përkohshme ose ta zëvendësojë atë me një vendim të ri për caktim të masave të përkohshme: Neni 306(3).

ushqyer me qumësht gjiri, fillimisht kishte mbetur nën kujdestari të paditëses; megjithatë, pak pas ndarjes familja e të paditurit e kishte marr fëmijës nga kujdestaria e paditëses. Paditësja pohoi se për fëmijën kujdesej e ëma e të paditurit, e cila ishte e vjetër dhe me shëndet të dobët, andaj nuk ishte në gjendje të kujdeset për fëmijën në mënyrë të duhur. Ajo argumentoi se, si rezultat i kujdesit jo-adekuat që ai po pranonte, fëmija kishte pësuar probleme serioze shëndetësore që rezultuan me hospitalizim të tij. Paditësja propozoi caktimin e masave të përkohshme, përfshirë kthimin e fëmijës nën kujdestari të saj dhe një urdhëresë me të cilën do të kërkohej nga i padituri që t'i paguaj asaj alimentacion, në pritje të zgjidhjes përfundimtare të rastit. Seanca e parë e rastit nuk ishte mbajtur deri në gusht të vitit 2009, afro pesë muaj pas ngritjes së padisë. Gjykata në atë seancë nuk morri parasysh propozimin e paditëses për masa të përkohshme, e as në katër seancat pasuese, në tetor dhe dhjetor të vitit 2009 dhe në janar e shkurt të vitit 2010. Në seancën e mbajtur në shkurt të viti 2010, përfundoi procedura e provave dhe u bënë fjalimet përfundimtare. Në asnjë pikë përgjatë 11 muajve të zhvillimit të procedurës, propozimi i paditëses për masa të përkohshme nuk u shqyrtua nga gjykata.

GjEDNJ ka përcaktuar se, për shkak të vet natyrës dhe qëllimit të tyre, propozimet për masa të përkohshme për kujdestari të [fëmijës] “normalisht duhet të trajtohen me një shkallë të caktuar prioriteti, përpos nëse ka arsye specifike për të mos e bërë këtë.”<sup>28</sup> Në rastin e mësipërm, propozimi përfshinte aranzhime të përkohshme për kujdes të fëmijës shumë të ri, i cili me gjasë ishte ende duke u ushqyer me qumësht gjiri dhe si i tillë ende ishte i varur nga paditësja për ushqim esencial. Veç kësaj, propozimi ngriti shqetësime serioze lidhur me kualitetin e kujdesit që fëmija po pranonte dhe implikimet për shëndetin e fëmijës. Duke pasur parasysh shqetësimet serioze të ngritura, propozimi është dashur të shqyrtohet pa vonesa nga gjykata. Dështimi për ta shqyrtuar propozimin në një datë të mëhershme – në fakt mos-shqyrtimi i saj në tërësi – është shkelje e qartë si e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe e kornizës ligjore në Kosovë.

Shumica e rasteve të monitoruara nga OSBE ku përfshiheshin propozime për masa të përkohshme ishin raste të kontesteve pronësore. Propozimet e tilla paraqesin një sfidë unike për gjykatat në Kosovë, pasi që kontestet pronësore përbëjnë pjesën më të madhe të ngarkesës me lëndë civile, dhe si të tilla mbeten të pazgjidhura për periudha të gjata kohore.<sup>29</sup>

Paditësi dhe i padituri posedonin parcela fqinje të pronës dhe ishin në proces gjyqësor lidhur me kontest për kufirin e vërtetë ndërmjet dy parcelave të pronës. Në shtator të viti 2009, paditësi kishte parashtruar një propozim për masa të përkohshme, me të cilin kërkonte nga gjykata që ta ndalojë të paditurin nga përzierja e mëtutjeshme në shfrytëzim dhe posedim të lehes së kopshtit për të cilën ai pohonte se është pjesë e pronës së tij. Paditësi pohonte se po që se nuk caktohen masat e tilla, kishte rrezik se i padituri do të ndërmerre hapa për të shndërruar pronën në atë mënyrë që do të ndalonte padinë e paditësit. Gjykata nuk e shqyrtoi rastin deri në tetor të vitit 2010.

<sup>28</sup> *Bevacqua dhe S.kundër Bullgarisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 12 qershorit 2008, paragrafi 68.

<sup>29</sup> Shih Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2010, SEC (2010) 1329, së bashku me Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Strategjia për Zgjerim dhe Sfidat Kryesore 2010–2011, {COM (2010) 660}*, p. 18, Bruksel, 9 nëntor 2010.

Gjatë seancës gjyqësore, gjykata urdhëroi që dy paditë të bashkëngjiten dhe të shqyrtohen së bashku, por nuk morri parasysh propozimin e paditësit për masa të përkohshme.

Në shembullin e rastit të mësipërm, gjykata dështoi që përgjatë periudhës trembëdhjetë mujore që nga propozimi për masa të përkohshme dhe seancës më të vonë gjyqësore të rastit, ta trajtojë në çfarëdo forme propozimin. Ky dështim për ta marr parasysh propozimin ose në mënyrë të zellshme, ose fare, qartë shkel si standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe kornizën ligjore në Kosovë. Veç kësaj, e vendos në rrezik që të ndalohej aktgjykimi përfundimtar i rastit.

Në vitin 1996, një paditës inicioi procedurën pranë një gjykatë komunale për bartje të një pjese të pronës së paluajtshme. Bartja do të bëhej në bazë të një urdhri të mëhershëm të gjykatës. Procedura mbeti jo-aktive për njëmbëdhjetë vite deri në vitin 2007, kur përfundimisht u caktua seanca e parë e rastit. Seanca e dytë u caktua për mars të vitit 2010. Megjithatë, pak para seancës së dytë, doli se ngastra e tokës në çështjen kontestuese ishte bartur në mënyrë mashtruese në vitin 2008, nga i padituri tek pala e tretë. Në qershor të vitit 2010, paditësi parashtrroi propozim për masa të përkohshme. Ai propozoi që së pari të ndalohej zyra e legalizimeve pranë gjykatës komunale që të legalizojë bartjen që është bërë me mashtrim, dhe së dyti të ndalohej drejtoria e regjistrave kadastral që të bëjë çfarëdo ndryshime në librat e kadastrës lidhur me ngastrën e tokës. Gjykata nuk u përgjigj në këtë propozim në asnjë pikë gjatë rrjedhës së tre seancave pasuese. Procedura është ende në zhvillim e sipër.

Siç u diskutua më herët në këtë raport, GjEDNJ ka përcaktuar se propozimet për caktim të masave të përkohshme duhet të shqyrtohen nga gjykatat “me zell të duhur dhe pa vonesa.”<sup>30</sup> Në shembullin e rastit të mësipërm, fakti se pjesa e tokës kontestuese ka qenë objekt i bartjes me anë të mashtrimit, është dashur ta alarmojë gjykatën për urgjencë të veçantë në shqyrtimin e këtij propozimi. Dështimi i gjykatës për ta shqyrtuar propozimin për masa të përkohshme në këto rrethana është veçanërisht shqetësues dhe ka shumë gjasa që të rezultojë me ndalimin e aktgjykimit përfundimtar mbi merita të padisë së paditësit.

Në maj të vitit 2010, paditësit iniciuan procedurën ku kërkonin vërtetimin e pronësisë të një pjese të tokës. Në qershor të vitit 2010, ata kërkuan nga gjykata një urdhër me të cilin do të ndalonte të paditurit që të mos ndërtojë objekt banesor në tokë, në pritje të aktgjykimit përfundimtar lidhur me çështjen e pronësisë. Ata pohuan se të paditurit në fakt kishin ndërmarr hapa për të marr lejen për ndërtimin e objektit banesor. Në pjesën e hershme të korrikut të vitit 2010, propozimi për masa të përkohshme ju kishte dërguar të paditurve. Në pjesën e vonshme të korrikut, të padituri parashtruan përgjigje me të cilën kundërshtonin caktimin e masave të përkohshme dhe kërkuan nga gjykata që të refuzojë propozimin e paditësve. Seancat gjyqësore ishin mbledhur në shtator dhe tetor të vitit 2010 për ta shqyrtuar propozimin, megjithatë për shkak të problemeve rreth ftesave, këto seanca ishin shtyrë pa u shqyrtuar ndonjëherë propozimi. Që nga data e përgatitjes së këtij raporti, diku

---

<sup>30</sup> *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 12 qershorit 2008, paragrafi 73.

pesë muaj pas propozimit për masa të përkohshme, ajo ende nuk është shqyrtuar nga gjykata.

Vlen të përmendet se në shembullin e rastit të mësipërm, gjykata bëri disa përpjekje për ta shqyrtuar propozimin për masa të përkohshme. Së paku, ai ju kishte dërguar të paditurve për përgjigje. Megjithatë, nuk është e qartë pse gjykata nuk ka mundur ta shqyrtojë dhe të vendos lidhur me propozimin. Nëse gjykata ka vlerësuar se nuk ka baza të mjaftueshme për të caktuar masat e propozuara, ajo ka mundur që thjeshtë ta hedh poshtë propozimin. Në vend të kësaj, propozimi nuk ishte proceduar më tej për një periudhë prej disa muajve dhe me siguri që akoma është në harresë. Në ndërkohë, të paditurit ka gjasa se kanë marr hapa të mëtutjeshëm drejt ndërtimit të objektit banesor, duke e vënë kështu në rrezik përmbarimin e vendimit përfundimtar të rastit.

Në qershor të vitit 2009, paditësit iniciuan procedurën në të cilën ata kërkonin përsëritjen e procedurës për vërtetimin e pronësisë nga e cila se gjoja ishin përjashtuar padrejtësisht. Ata pohuan se të paditurit e kanë mashtruar gjykatën lidhur me ekzistencën dhe/ose vendqëndrimin e tyre, dhe argumentuan se mbi këtë bazë kanë të drejtën për rigjykim. Ata po ashtu propozuan caktimin e masave të përkohshme për t'i ndaluar të paditurit nga tjetërsimi, ngarkimi apo ndonjë ndryshimi tjetër të “strukturës” së pjesës të tokës bujqësore që është objekt thelbësor i procedurës trashëgimore. Të paditurit argumentuan se gjykata nuk do të duhej të lëshoj kurrfarë urdhri për masa të përkohshme, në veçanti duke pasur parasysh se veç se kishte një aktgjykim në favor të tyre. Rasti procedoi në seancë të shqyrtimit në tetor të vitit 2010. U zhvillua proceduara e provave pas së cilës u dhanë fjalimet përfundimtare. Palët janë tani në pritje të ndonjë vendimi tjetër apo aktgjykim të rastit.

Shembulli i rastit të mësipërm paraqet një model të ndërlikueshëm faktesh në atë se trashëgimia në thelb të padisë veç se ishte shqyrtuar nga gjykata dhe ishte marr aktgjykim përfundimtar. Megjithatë, ndërlikueshmëria nuk është pengesë për shqyrtim të masave të përkohshme. Propozimi ndodhej pranë gjykatës dhe dështimi për ta marr atë parasysh ishte shkelje si e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe e kornizës ligjore në Kosovë.

## **PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME**

Ky raport nënvizon mangësi serioze në shqyrtimin e propozimeve për masa të përkohshme nga gjykatat në Kosovë. Në rastet e vëzhguara nga OSBE-ja, propozimet e tilla nuk u trajtuan as me shpejtësinë, e as me zellin e duhur. Në shumë raste, propozimet siç duket nuk janë trajtuar fare nga gjykatat. Në disa raste, duket se gjykata e përfshirë ose nuk ka qenë në gjendje ose nuk ka pasur vullnet që ta ndajë propozimin për masa të përkohshme në një anë, nga padia mbi meritat në anën tjetër dhe ta shqyrtojë të parën pavarësisht nga e dyta.

Gjykatat në Kosovë kanë obligim pozitiv t'i shqyrtojnë propozimet për masa të përkohshme dhe këtë gjë ta bëjnë me zell dhe pa vonesa. Për shkak të vet natyrës dhe qëllimit të tyre, propozimet për masa të përkohshme duhet të shikohen si urgjente dhe duhet të trajtohen me një shkallë të caktuar të urgjencës. Caktimi i masave të tilla mund të jetë i domosdoshëm për të siguruar efikasitetin e aktgjykimit përfundimtar



mbi meritat e rastit. Kur gjykatat dështojnë t'i trajtojnë propozimet e tilla shpejt dhe me zell të duhur, përmbartimi i aktgjykimit përfundimtar mund të vendoset në rrezik të konsiderueshëm. Caktimi i masave të përkohshme në shumë raste do të jetë dallimi ndërmjet asaj që të jetë apo të mos jetë i mundshëm përmbartimi i aktgjykimit.

#### **Për gjykatat:**

- Të sigurojnë që propozimet për masa të përkohshme të trajtohen shpejt dhe me zellin e duhur;
- Të sigurojnë që gjyqtarët civil që shqyrtojnë rastet ku përfshihen propozime për masa të përkohshme të kenë njohuri lidhur me dispozitat e LPK-së që rregullojnë shqyrtimin e propozimeve të tilla;
- Të zhvillojnë dhe zbatojnë një strategji gjithëpërfshirëse dhe pro-aktive për menaxhim të rasteve që ta përdorin në rastet civile ku përfshihen propozimet për masa të përkohshme; dhe
- Të shfrytëzojnë në tërësi procedurën përgatitore për të parashikuar dhe për të trajtuar propozimet për masa të përkohshme.

#### **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:**

- Të vazhdojë trajnimin e gjyqtarëve civil mbi ligjin që ka të bëjë me masat e përkohshme; dhe
- Të merr parasysh ofrimin e një trajnimi më të gjerë për gjyqtarët civil, mbi aftësitë e menaxhimit pro-aktiv të rasteve.

#### **Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:**

- Të vazhdojë trajnimin mbi përdorimin e sistemeve informative për menaxhim të rasteve; dhe
- Të merr parasysh ofrimin e trajnimeve të veçanta për personelin e gjykatave lidhur me përdorimin e sistemeve informative për menaxhim të rasteve në rastet urgjente siç janë propozimet për masa të përkohshme.